

TAKSAT E MJEDISIT NË SHQIPËRI

2024

Në vitin 2024, të ardhurat nga taksat mjedisore arritën në rreth 66,2 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 9.45 % krahasuar me vitin 2023.

Struktura e të ardhurave nga taksat mjedisore dominohet nga taksat e energjisë, të cilat përbëjnë 82,2 % të totalit. Taksat e transportit përfaqësojnë 13 %, ndërsa taksat e ndotjes zënë 4,7 %. Taksat mbi burimet natyrore kanë një peshë shumë të ulët në total, me vetëm 0,08 %.


Gjatë vitit 2024, të ardhurat nga taksat e energjisë kanë shënuar rritje prej 8,95 %, të ardhurat nga taksat transportit u rriten me 10,53 %.

Gjatë të njëjtës periudhë, të ardhurat nga taksat e ndotjes kanë shënuar një rritje me 16,30 %, ndërsa të ardhurat nga taksat e burimeve natyrore kanë pësuar rënie prej 18,77 % (Tab. 2).

Në vitin 2024, pesha e të ardhurave nga taksat mjedisore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) arriti në 2,63 %, duke shënuar një rritje prej 0,08 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023.

Të ardhurat nga taksat mjedisore përbënin 10,04 % të totalit të të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore në vitin 2024, duke shënuar një rënie prej 0,3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2023 (Tab. 3).

FIG. 1 PESHA QË ZËNË TË ARDHURAT E TAKSAVE MJEDISORE NDAJ TAKSAVE GJITHSEJ, KONTRIBUTEVE SHOQËRORE DHE PBB-SË (%)



Burimi: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përpunimi INSTAT

TAB. 1 TË ARDHURAT NGA TAKSAT MJEDISORE, SIPAS LLOJEVE (MILIONË LEKË)

	2023	2024
Taksat e Energjisë	49.925	54.392
Taksat e Transportit	7.795	8.616
Taksat e Ndotjes	2.692	3.131
Taksat e Burimeve Natyrore	61	50
Gjithsej	60.474	66.189

Burimi: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përpunimi INSTAT

TAB. 2 RITJA VJETORE DHE STRUKTURA E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT MJEDISORE, SIPAS LLOJEVE (%)

	Rritja vjetore (%)		Struktura	
	2023	2024	2023	2024
Taksat e Energjisë	9,17	8,95	82,56	82,18
Taksat e transportit	8,78	10,53	12,89	13,02
Taksat e Ndotjes	7,90	16,30	4,45	4,73
Taksat e Burimeve Natyrore	-13,76	-18,77	0,1	0,08

Burimi: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përpunimi INSTAT

TAB. 3 TË ARDHURAT TATIMORE MJEDISORE (%)

	2023	2024*
Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto(PBB)	2,55	2,63
Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj taksave gjithsej dhe kontributeve shoqërore	10,10	10,04

2024*Janë përdorur të dhënat gjysmë-finale të PBB –së

Burimi i të dhënave: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përpunimi INSTAT

Shënim për përdoruesit: Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Taksat e Mjedisit në Shqipëri](https://www.instat.gov.al/)

Metodologjia

Llogaritë e taksave të lidhura me mjedisin

Taksat mjedisore konsiderohen si një instrument ekonomik për të kontrolluar ndotjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe ato janë konceptuar për të ndikuar në sjelljen e bizneseve, prodhuesve dhe konsumatoreve. Taksat mjedisore janë modul i llogarive ekonomike në mjedis, pjesë e sistemit të Llogarive Kombëtare.

TVSH dhe taksat e tjera nuk përfaqësojnë një taksë me ndikim direkt parandalues ose frenues të produkteve që dëmtojnë mjedisin, si dhe nuk përdoret në formë ekskluzive për mbrojtjen e mjedisit. Si rezultat këto taksa janë të përjashtuara nga këto vlerësime.

Lista kombëtare e taksave paraqet pikënisje për vlerësimin e të ardhurave nga taksat mjedisore. Metodologjia e përdorur për llogaritjen e tyre është bërë në përputhje me Rregulloren (BE) Nr 691/2011 dhe udhëzimet e Eurostat: "Taksat mjedisore, një udhëzues statistikor". Këto të dhëna janë të harmonizuara me Sistemin Evropian të Llogarive Ekonomike (ESA 2010).

Të dhënat e taksave mjedisore janë siguruar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Të dhënat e taksave mjedisore janë subjekt rishikimi.

Për më shumë referohu : https://instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf

Përkufizime

Më poshtë paraqiten përkufizimet e katër grupeve kryesore të taksave mjedisore:

Taksat e energjisë, përfshijnë taksat mbi produktet energjetike, duke përfshirë karburantet për automjete, si dhe taksat mbi prodhimin dhe përdorimin e energjisë në vend. Në këtë kategori përfshihen gjithashtu tatimet mbi bio-karburantet dhe format e tjera të energjisë nga burime të rinovueshme, si dhe taksat mbi rezervat e produkteve energjetike.

Taksat e transportit, i referohen kryesisht taksave mbi pronësinë dhe përdorimin e mjeteve të transportit, me përjashtim të karburanteve. Këtu përfshihen gjithashtu taksat mbi mjete të tjera transporti, si avionë, anije dhe trena, si dhe shërbimet e lidhura me to.

Taksat e ndotjes, përfshijnë taksat mbi emetimet në ajër dhe shkarkimet në ujë, si dhe mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe zhurmën. Përjashtohet tatimi mbi emetimet e CO₂, i cili klasifikohet në kategorinë e taksave të energjisë.

Taksat e burimeve natyrore, përfshijnë taksat mbi nxjerrjen dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, si uji, pyjet dhe fauna e egër.